

LAERT DURAJ



Datëlindja: 10.11.1972

Vendlindja: Tepelenë

Email: Laert.Duraj@parlament.al

Jetëshkrimi:

Z. Laert Duraj ka përfunduar studimet në degën Administrim Biznes në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Tiranës në vitin 1995.

Pas përfundimit të studimeve ka punuar si specialist i vlerës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në Gjirokastër 1997-1999.

Ai ka një përvojë të pasur si administrator i disa shoqërive. Gjatë 2012-2015 ka administruar BluePoint Petroleum SHPK, në 2015-2017 shoqërinë KPT SHPK, në të cilën është edhe bashkëthemelues dhe në 2017-2021 ka qenë administrator i Postës Shqiptare.

Gjithashtu, për një periudhë të shkurtër kohore, ai ka qenë drejtor ekonomik i Gazetës “Standard” dhe Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm për çështjet ligjore në UKT SHA në periudhën nëntor 2015-janar 2016.

Gjatë viteve 2006-2010, ai ka bashkëthemeluar Universitetit Evropian të Tiranës duke mbajtur njëkohësisht edhe postin e kancelarit.

Z. Duraj është anëtar i Partisë Socialiste të Shqipërisë që prej vitit 1994 dhe në vitin 2018 është emëruar Sekretar për Emigracionin në PSSH. Gjatë periudhës 2007-2011 ka qenë anëtar i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Tiranë.

Ai ka kandiduar për deputet të Republikës së Shqipërisë edhe më herët në zgjedhjet parlamentare të 2017, por vetëm të zgjedhjet parlamentare të 2021 u mandatua për herë të parë si deputet.

Z. Duraj ka kryer trajnime për menaxhimin politik dhe zhvillimin e lidershit të përfaqësuesve të forcave politike.